

June 12, 1961

**Report on the meeting between Delo Balili, the
Albanian ambassador to Cairo, and Raúl Roa**

Citation:

"Report on the meeting between Delo Balili, the Albanian ambassador to Cairo, and Raúl Roa", June 12, 1961, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh V. 1961 D. 422, p. 21
<https://wilson-center-digital-archive.dvincitest.com/document/110165>

Summary:

Raúl Roa is the head of the Cuban delegation to the preparatory conference for the upcoming non-aligned countries conference. Roa invited all the diplomats of socialist countries to his mansion for lunch on June 9. He informed the diplomats about the different groups established in the conference concerning their opinions on revisionism. On one hand, was India, Cambodia, Nepal, Burma, Algeria and Yugoslavia. All of them request that there will be no display of anti-imperialist and anti-colonialist spirit at the conference. On the other hand, Cuba, Guinea, Mali, Ghana, Ceylon, and to a certain extent the UAR and Iraq, requested that there should be anti-imperialist and anti-colonialist discourse during the conference. Roa also informed that Belgrade was decided upon to be the location of the conference. At first upon hearing that Belgrade would be the location Roa hesitated, but later he decided to participate in order to create a "left-wing" group with anti-imperialist character in the conference. He received the recommendation for the creation of this group from the Soviet, Chinese and Czech delegations. After the meeting, Malile was informed that Roa has prolonged his stay in Cairo because the Arabs and Indians agreed jointly to make some changes to the conference documents during their printing. Roa intended to stay in order to halt these actions.

Original Language:

Albanian

Contents:

Original Scan

Viti
dosja

I DEKLASIFIKUAR

Kajro, 12 qershor 1961 MPJ ARKIVI

RAPORT - BISEDIMI

Viti:
Dosja: Fletai sh. Delo Balili me Ministrin e Jashtem te Kubes, Raul Roa.-

Ministri i jashtem i Kubes, Raul Roa, ndodhej ne Kajro prej disa dite si kryetar i delegacionit kuban ne konferencen pregatitore te vendvet te pangazhuara. Me qe konferenca, sipas planit fillestar, po i afrohej fundit, ai me anen e ambasadorit çek (me qe dhe ambasadori kuban ish i zene ne konferenc) lajmeroi gjithë perfaqesurit e vendvet te kampit socialist qe te venim tek ai per dreke me date 9 qershor. Ne oren e caktuar vajtem atje te gjithë, perveç pollakut qe nuk kish pranuar te vinte me ftesen e çekut por dante qe kubani ta ftonte vete. Aty ishin prezent edhe konsulli i Gjermanise lindore, si dhe shefat e perfaqesivet tregtare te Kores e Vjetnamit. Vete Roa dhe ambasadori erdhen me vonese me qe konferenca ish zgjatur dhe po zhvillohej ne nje atmosfere te ndere dhe lufte politike te ashper.

Me te ardehe Roa na njoftoi se me pare pat vendose qe me mbarimin e konferences sot, nesor te shtunen te nisej me avjon per Prage, por me qe konferenca pa zgjatej dhe po merte nje karakter te hapet lufte midis tri tendencave kryesore te ndryshme qe paraqiste nje interes te madh jo vetem per Kuben por edhe per gjithë "familjen tone socialistë", siç e cilesoi ai, nisjen per ne Prage e kish shtyre per te henen. Pastaj ai na foli per disa ane te diskutimevet ne konference dhe sidomos per perpjekjet e Indis, Kambexhes, Nepalit, Afganistanit, Birmanis, Sudanit dhe Jugosllavis per te çdukur çdo gje nga fryma anti-imperjaliste e anti-kollonialiste qe mund te manifestohej ne konference, kurse delegacioni i Kubes, me perkrahjen e atij te Guines, te Malit, te Ganes, te Cejllonit e deri diku dhe atij te RAB-it e te Irakut dhe vendvet tjera te konferences Kazabllankes, mundohen, kush me shume e kush me pak, qe kjo fryme te mos zhduket. Ai tregoi se Indija dhe grupi qe e ndjekin ate, kundershuan edhe pjesemarrjen e Kongos e te Algjeris ne Konference por pastaj pranuan Algjerin per ti bere qejfin RAB-it ndersa per Kongon nuk pranuan gje qe ka shkakeluar nervozizen te madh ne delegacionin e Ganes e cili ka kerkuar te marre disa here fjalen ne konference per kete çeshtje. Indija ka propozuar vete pjesemarrjen e shume vendvet tjera ne konference sidomos atyre antare te Kommenwelthe-it, te Komunitetit freng, te SEATO-s dhe te atyre skandinave e te vendvet antare te organizates pan-amerikane "OAS" si Nigerin, Mallajen, Austrin, Fjllanden, Norvegjin, Suedin, Angjentinen, Gilin etj. Vete une tha Roa propozova perseritjen e fteses per Meksiken dhe ftesen e Bolivia dhe te Ekuadorit; por, ai tha se te gjitha keto propozime nuk kane per tu pranuar me mbasi kane frik nga shtimi i numrit pjesemarrresvet se mos deshton fare Konference e ardheshme ose mos pengohet fare marrja e nonje rezolute sado formale ose e çale qofte. Pastaj Roa na tregoi se ne lufte e ashper u zhvillua e vazhdon per vendin se

.. / ..

I DEKLASIFIKUAF 2 -

VIFI;
Dokjant Fleta!

ku do behet konferenca e ~~vendoset~~ kryetarevet te qeverrivet te vendeve te pa-angazhuara: ai tha se per kete, vete Roa kish propozuar ne fillim qe te behej ne Havana dhe propozimin e tij e kishin perkrahe Guinea e Mali, por nuk pati me shume perkrahje me gjithë qe Roa kish folë mbi 3 ore ne konferencë per kete çeshtje; me pastaj ai pa se pati shume propozime per ne Beograd, prandaj per ta penguar kete ai propozoi qe konferenca te behej ne Kaj-ro me qellim qe te terhigte me vehte ne kete çeshtje vendet e Konferences Kazabllankes e ato arabet, por edhe ne kete e perkrahen vetem Guinea, Mali, Algjerija e Arabija Saudite, kurse vete RAB-i dhe gjith vendet e tjera perkrahen propozimin per ne Beograd. Roa tha se mejtonte te njoftonte Pawzine (ministri e jashtem te RAB-it qe eshte dhe kryetar i mbledhjes pregatitore) se ne qofte qe mbledhja do vendoset per ne Beograd, Kuba mund te mos marre pjesë fare. Atehere, disa nga ambasadoret si sovjetiku, çeku e kinezi i thane se duhej pare çeshtja mbasi mund te ishte me mire te mirnit pjese dhe te organizonit atje brenda krahu e majte duke i dhane nje karakter me anti-imperjalist konferences. Roa nuk u pergjigj aty per aty ketyre sugjerimevet por na dha te kuptonim se po mejtonej per te dhe me von, ne nje takim sot paradite me ambasadorin kuban, me tha se Ministri mejtonte se me gjithë qe u vendos qe konferenca e larte te behej ne Beograd, Kuba mund te marre pjese per te mos i lene Indin e Jugosllavin te benin si te donin por te luftonte rriti dhen konferences nje karakter revolucionar duke terheqe ne anen tone edhe RAB-in e vendet e tjera qe kane kontradikta me Indin e Jugosllavin (kryesisht per sa i perket vendit te liderit kryesor ne Konferencë). Roa na tregoi se nje lufte akoma me e ashper eshte zhvilluar e po vazhdon per rendin e dites se mbledhjes larte dhe se ai vete kish propozuar nje rend dite me 10 pikë krejtësisht politike, kurse Indija mundohet qe ne rend te dites te kete vetem çeshtje te pergjitheshme. Pastaj ai, me anen e ambasadorit tyre, na shparndau nga nje kopje te fjalimit tij fillestar qe kish mbajte ne konferencen pregatitore te cilin po ju a dergojme bashkangjite.

Ambasadori kuban me tha sot se ministri Roa as sot te henen muk kish ike per Prage mbasi kish pare se me gjithë qe vendimet kryesore te konferences u muaren dhe ish in te mira, arabet dhe indianet kishin rrene dakord qe ti ndryshonin ato gjate shtypjes se tyre ne maqine, gje qe e kishin marre vesh delegacionet e tjera dhe per kete Roa vendosi te qendroje gjer sa vendimet e marra te dalin krejt nga shtypi.



AMBASADORI
(Palo Balili)

ne 3 kopje nga D.E.
ndnes, 1 ne doja.

[Handwritten signature]